

VENDIM
Nr.332, datë 21.5.2004

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT DHE TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË SË FIERIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË ISH-
UZINËS SË FERMENTIMIT TË DUHANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 2 shkronja “c”, 3, 5, 6, 8, 9 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të ish-uzinës së fermentimit të duhanit dhe transferimin e tyre në pronësi të bashkisë së Fierit, sipas dokumentacionit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të përbërë nga formulari, planimetria dhe planvendosja.

2. Mjediset e ish-uzinës së fermentimit të duhanit të përdoren për ngritjen e një qendre publike të formimit profesional.

3. Ngarkohen Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, kryetari i bashkisë së Fierit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano